**ALPIQ ENERGY ALBANIA SHPK**
**Pasqyrat Financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020**

**PËRMBAJTJA:**

| | FAQE |
|---|---|
| PASQYRAT FINANCIARE: | |
| PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR | 2 |
| PASQYRA E PERFORMANCËS | 3 |
| PASQYRA E NDRYSHIMEVE NË KAPITAL | 4 |
| PASQYRA E FLUKSIT TË MJETEVE MONETARE | 5 |
| SHËNIMET SHPJEGUESE TË PASQYRAVE FINANCIARE | 6 - 16 |

**Pasqyra e Pozicionit Financiar
më 31 dhjetor 2020**

| | Shënime | 31 dhjetor 2020 | 31 dhjetor 2019 |
|---|---|---|---|
| **AKTIVET** | | | |
| **Aktive afatshkurtra** | | | |
| Mjete monetare | 4 | 6,495,717 | 12,333,846 |
| Llogari të arkëtueshme nga palët e lidhura | 5 | 15,069,669 | 13,286,843 |
| Të tjera llogari të arkëtueshme | 6 | 1,613,640 | 1,294,395 |
| Shpenzime te shtyra | 7 | 643,371 | - |
| **Totali i aktiveve afatshkurtra** | | **23,822,397** | **26,915,084** |
| **Aktivet afatgjata** | | | |
| Aktive afatgjata materiale | 9 | 455,118 | 231,215 |
| Te tjera llogari te arketueshme afatgjata | 10 | 291,848 | 291,848 |
| **Totali i aktiveve afatgjata** | | **746,966** | **523,063** |
| **Totali i aktiveve** | | **24,569,363** | **27,438,147** |
| **DETYRIMET** | | | |
| **Detyrime afatshkurtra** | | | |
| Llogari të pagueshme tregtare | 11 | 113,957 | 728,754 |
| Të pagueshme ndaj palëve të lidhura | 12 | 8,975,986 | 9,657,333 |
| Hua nga palet e lidhura | 13 | 12,370,000 | 14,307,975 |
| Detyrime tatimore | 14 | 191,646 | 173,876 |
| Të tjera detyrime | 15 | 1,018,545 | 982,885 |
| **Totali i detyrimeve afatshkurtra** | | **22,670,134** | **25,850,823** |
| **Detyrime afatgjata** | | | |
| **Totali i detyrimeve afatgjata** | | **-** | **-** |
| **Totali i detyrimeve** | | **22,670,134** | **25,850,823** |
| **Kapitali** | | | |
| Kapitali i nënshkruar | | 17,625,000 | 17,625,000 |
| Fitime/( Humbje) të mbartura | | (16,037,676) | (16,294,744) |
| Humbja e ushtrimit | | 311,905 | 257,068 |
| **Totali i kapitalit** | 16 | **1,899,229** | **1,587,324** |
| **Totali i kapitalit dhe detyrimeve** | | **24,569,363** | **27,438,147** |

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 6 deri në 16, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

**Pasqyra e Performancës**
**Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020**

| | Shënime | Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020 | Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019 |
|---|---|---|---|
| Të ardhura nga aktiviteti i shfrytëzimit | 17 | 15,069,669 | 13,286,843 |
| Të ardhura/shpenzime të tjera të shfrytëzimit | 18 | (407,213) | (11,277) |
| **Lënda e parë,materiale të konsumueshme dhe të tjera shpenzime** | | **(9,385,139)** | **(9,502,348)** |
| 1) Lënda e parë, materiale të konsumueshme dhe shpenzime të tjera | | - | - |
| 2) Të tjera shpenzime | 19 | (9,385,139) | (9,502,348) |
| **Shpenzime të personelit** | 20 | **(4,277,476)** | **(3,328,843)** |
| 1) Paga dhe shpërblime | | (3,848,479) | (2,915,702) |
| 2) Shpenzime të sigurimeve shoqërore/shëndetësore | | (428,997) | (413,141) |
| Shpenzime konsumi dhe amortizimi | 21 | (121,934) | (62,250) |
| **Shpenzime financiare** | 22 | **(455,306)** | **(14,328)** |
| 1) Shpenzime interesi dhe shpenzime të ngjashme | | (219,821) | (238,948) |
| 2) Te ardhura, shpenzime të tjera financiare | | (235,485) | 224,620 |
| **Fitimi/humbja para tatimit** | | **422,601** | **367,797** |
| **Shpenzimi i tatimit mbi fitimin** | 23 | **(110,696)** | **(110,729)** |
| 1) Shpenzimi aktual i tatimit mbi fitimin | | (110,696) | (110,729) |
| **Fitimi/humbja e vitit** | | **311,905** | **257,068** |
| **Totali i të ardhurave të tjera gjithpërfshirëse për vitin** | | - | - |
| **Totali i të ardhurave gjithpërfshirëse për vitin** | | **311,905** | **257,068** |

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 6 deri në 16, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

**Pasqyra e Ndryshimeve në Kapital**
**Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020**

| | Kapitali i nënshkruar | Fitim/(Humbje)e Pashpërndarë | Fitim / (Humbja) e vitit | Totali |
|---|---|---|---|---|
| **Pozicioni më 1 janar 2019** | **17,625,000** | **(16,493,347)** | **198,603** | **1,330,256** |
| Fitimi / (Humbja) e vitit | - | - | 257,068 | 257,068 |
| Transferime në fitim/(humbje) të mbartura | - | 198,603 | (198,603) | - |
| **Pozicioni më 31 dhjetor 2019** | **17,625,000** | **(16,294,744)** | **257,068** | **1,587,324** |
| Fitimi / (Humbja) e vitit | - | - | 311,905 | 311,905 |
| Transferime në fitim/(humbje) të mbartura | - | 257,068 | (257,068) | - |
| **Pozicioni më 31 dhjetor 2020** | **17,625,000** | **(16,037,676)** | **311,905** | **1,899,229** |

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 6 deri në 16, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Pasqyrat financiare të Shoqërisë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020 janë aprovuar nga administratorët e shoqërisë "Alpiq Energy Albania" Shpk më 23/03/2021 dhe janë firmosur si më poshtë.

**Anastasia Krivosheeva, Zdeněk Cihák**
Administrators

ALPIQ
Alpiq Energy Albania Sh.p.k
NUIS: K 91906013 R

Mazars shpk

**Mazars shpk**
Përpilues i pasqyrave financiare

mazars
Emin Duraku Str., Binjaket Build., No.5, 1013, Tirana, Albania
NUIS: K32123006W

**Pasqyra e Fluksit të Mjeteve Monetare**
**Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020**

| | Shënime | Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020 | Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019 |
|---|---|---|---|
| **Flukset e parasë nga aktivitetet operative** | | | |
| Fitim / Humbja e vitit | | 311,905 | 257,068 |
| Rregullimet për shpenzimet jomonetare: | | | |
| Shpenzimet financiare jomonetare | | (235,485) | 204,410 |
| Shpenzime konsumi dhe amortizimi | | 121,934 | 62,250 |
| Rënie/(rritje) në të drejtat e arkëtueshme dhe të tjera | | (2,745,442) | (1,612,569) |
| Rritje/(rënie) në detyrimet e pagueshme | | (3,587,902) | 4,639,673 |
| **Mjete monetare neto nga/(përdorur në) aktivitetin e shfrytëzimit** | | **(6,134,990)** | **3,550,832** |
| **Fluksi i Mjeteve Monetare nga/(përdorur në) aktivitetin e investimit** | | | |
| Pagesa për blerjen e aktiveve afatgjata materiale | | **(345,837)** | **(20,336)** |
| **Mjete monetare neto nga/(përdorur në) aktivitetin e investimit** | | (345,837) | (20,336) |
| **Fluksi i Mjeteve Monetare nga/(përdorur në) aktivitetin e financimit** | | - | - |
| **Mjete monetare neto nga/(përdorur në) aktivitetin e financimit** | | - | - |
| **Rritje/(rënie) neto në mjete monetare dhe ekuivalentë të mjeteve monetare** | | **(6,480,827)** | **3,530,496** |
| Mjete monetare dhe ekuivalentë të mjeteve monetare më 1 janar | | 12,333,846 | 8,996,483 |
| Efekti i luhatjeve të kursit të këmbimit të mjeteve monetare | | 642,698 | (193,133) |
| **Mjete monetare dhe ekuivalentë të mjeteve monetare më 31 dhjetor** | 4 | **6,495,717** | **12,333,846** |

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 6 deri në 16 të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

## 1. Informacion i përgjithshëm

"Alpiq Energy Albania" shpk, me NIPT K91906013R është rregjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit si një kompani me përgjegjësi të kufizuar me 06/07/2009.

Objekti i aktivitetit të shoqërisë është Transport dhe shitje e energjisë, shitje, prodhim, përfaqësim tregtar dhe agjensi.

Zyra qëndrore e Shoqërisë ndodhet në rrugën "Dëshmorët e 4 Shkurtit", Sky Tower Bldg, Tiranë.

Më 31 dhjetor 2020 shoqëria kishte 2 punonjës (2019: 2 punonjës).

## 2. Bazat e përgatitjes së pasqyrave financiare

### 2.1. Deklarata e pajtueshmërisë

Pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit të përmirësuara (SKK) dhe ligjin nr.25/2018, datë 10 maj 2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare" I cili hyri ne fuqi në 1 janar 2019 dhe udhëzimeve shtesë të aplikueshme në përputhje me nenin 16 të ligjit të sipërpërmendur.

### 2.2. Bazat e matjes

Pasqyrat financiare janë përgatitur bazuar në koston historike.

### 2.3. Biznesi në vijimësi

Pasqyrat financiare të Shoqërisë përgatiten mbi supozimin e biznesit në vijimësi, i cili merr parasysh se Shoqëria do të vazhdojë ekzistencën e aktivitetit të saj për një të ardhme të parashikuar.

### 2.4. Monedha funksionale dhe e paraqitjes

Këto pasqyra financiare janë paraqitur në Lek, e cila është dhe monedha funksionale e Shoqërisë.

### 2.5. Vlerësime dhe gjykime

Përgatitja e pasqyrave financiare ne përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit të Përmirësuara kërkon nga drejtuesit të ushtrojnë gjykimin e tyre në proçesin e zbatimit të politikave kontabël të shoqërisë dhe shumave të raportuara të aktiveve, detyrimeve, të ardhurave dhe shpenzimeve. Rezultati aktual mund të ndryshojë nga këto vlerësime.
Vlerësimet dhe gjykimet rishikohen në mënyrë të vazhdueshme. Rishikimet e vlerësimeve kontabël janë të njohura në periudhën në të cilën vlerësimi është rishikuar si dhe në periudhat e ardhshme që preken.

Në veçanti, informacion mbi fushat më të rëndësishme të vlerësimeve dhe gjykimeve në aplikimin e politikave kontabël të cilat kanë efektet më të rëndësishme në shumat e njohura në pasqyrat financiare, janë përshkruar në shënimet e pasqyrave financiare.

#### 2.5.1. Perdorimi i vleresimit dhe gjykimit lidhur me efektin e pandemise ne vijimesine e biznesit.

Ndërsa situata pandemike COVID-19 ende po evoluon në Shqipëri dhe në mbarë botën, ka pasiguri të lartë mbi shtrirjen e saj në kohën e lëshimit të këtyre pasqyrave financiare. Si pasojë, menaxhimi nuk është në gjendje të vlerësojë me siguri dhe të sigurojë një vlerësim sasior të ndikimit të mundshëm të kësaj pandemie në kompani. Ndërsa masat kufizuese vazhdojnë, volumi i shitjeve, fluksi i parasë, (zhvlerësimi i aktiveve, inventari, vlera e drejtë, etj..) dhe fitimi mund të ndikohen. Sidoqoftë, në datën e këtyre pasqyrave financiare, kompania po operon, vazhdon të përmbushë detyrimet e saj në kohën e duhur dhe për këtë arsye vazhdon të zbatojë parimin e vijimësisë në përgatitjen e pasqyrave financiare

### 2.6. Krahasueshmëria e informacionit kontabël

Siç paraqitet në Standardin Kombëtar të Kontabilitet të përmirësuar nr.1, në rastet e një ndryshimi në paraqitjen e pasqyrave financiare si pasojë e kërkesave të një standardi të ri, një përmirësimi në standard apo një ndryshimi në ligjin për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare", informacioni krahasues duhet të riparaqitet për të korresponduar me paraqitjen e re, përvec rasteve kur riparaqitja e informacionit krahasues nuk mund të vlerësohet në mënyrë të besueshme.

**Politikat Kontabël**

Politikat kontabël të mëposhtme janë aplikuar në mënyrë konsistente në të gjitha periudhat e paraqitura në pasqyrat financiare.

### 2.7. Transaksionet në monedhë të huaj

Transaksionet në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale dhe regjistrohen me kursin e këmbimit në datën e transaksionit. Aktivet dhe detyrimet monetare në monedhë të huaj në datën e raportimit konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit në datën e bilancit. Fitimi ose humbja nga këmbimi në zëra monetarë është diferenca që vjen nga këmbimi i një numri të caktuar njësish të një monedhe të huaj në monedhën funksionale me kurse të ndryshme këmbimi në datat e këmbimit. Të drejtat dhe detyrimet jo-monetare në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës së kryerjes së transaksionit ndërsa ato që maten me vlerë të drejtë rikëmbehen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës kur është përcaktuar vlera e drejtë. Diferencat që rezultojnë nga kursi i këmbimit kalojnë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Kursi i këmbimit i monedhave të huaja më 31 dhjetor 2020 dhe 31 dhjetor 2019 është detajuar si më poshtë:

| Kursi i këmbimit | 2020 | 2019 |
|---|---|---|
| Euro/LEK | 123.7 | 121.77 |

### 2.8. Instrumentat financiarë

Një instrument financiar njihet nëse Shoqëria bëhet palë në kushtet kontraktuale të instrumentit. Shoqëria në fillim regjistron aktivet dhe detyrimet financiare me vlerën e tyre të drejtë.
Shoqëria çregjistron një aktiv financiar kur skadojnë të drejtat kontraktuale të shoqërisë mbi flukset e parasë së aktivit financiar ose kur shoqëria transferon aktivin financiar tek një palë e tretë pa mbajtur kontrollin ose gjithë risqet dhe përfitimet thelbësore të aktivit.

Mjetet *monetare*

Mjetet monetare përfshijnë arkën dhe llogaritë rrjedhëse në bankë.

*Llogari të arkëtueshme*

Llogaritë e arkëtueshme njihen fillimisht me vlerën e drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar duke zbritur humbjen nga zhvlerësimi. Provigjioni për zhvlerësimin e aktiveve të arkëtueshme llogaritet kur ka të dhëna se shoqëria nuk do të jetë në gjendje të mbledhë të gjitha detyrimet.

*Llogari të pagueshme*

Llogaritë e pagueshme paraqiten me vlerën e tyre të drejtë.

*Hua të marra dhe të dhëna*

Huatë e marra dhe të dhëna njihen fillimisht dhe mbahen në vazhdim me vlerën e tregut, pa përfshirë koston e transaksioneve.

*Kapitali themeltar*

Kapitali themeltar njihet me vlerën nominale.

## 3. Politikat Kontabël (vazhdim)

### 3.3 Aktive afatgjata materiale

*i. Njohja dhe matja*

Të gjitha aktivet afatgjata materiale paraqiten me kosto duke zbritur zhvlerësimin dhe amortizimin e akumuluar.
Kostoja përfshin shpenzime të cilat lidhen drejtpërdrejt me blerjen e aktivit.
Fitimet dhe humbjet nga shitjet, apo nxjerrjet jashtë përdorimit përcaktohen duke krahasuar vlerën e shitjes me vlerën e mbetur dhe këto përfshihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

*ii. Amortizimi*

Amortizimi i aktiveve llogaritet duke përdorur metodën e vlerës së mbetur të amortizimit mbi jetën e vlerësuar të çdo pjese të aktivit afatgjatë material duke filluar nga dita e parë e muajit që pason muajin e blerjes.

Normat e amortizimit per efekt fiskal për vitin aktual jane si më poshtë:

| Aktive | Përqindja |
|---|---|
| Kompjutera dhe pajisje informatike | 25% |
| Mobilje zyre | 20% |

Metoda e amortizimit, jeta e dobishme dhe vlera e mbetur rishikohen në çdo datë raportimi.

*iii. Çregjistrimi*

Një zë i aktiveve afatgjata materiale çregjistrohet kur ai nxirret jashtë përdorimit apo atëhere kur nuk priten më përfitime ekonomike të ardhshme nga përdorimi apo nxjerrja e tij jashtë përdorimit.
Fitimet dhe humbjet në rastin e nxjerrjes jashtë përdorimit të aktiveve afatgjata materiale, përcaktohen sipas shumës së tyre të mbetur dhe merren parasysh në nxjerrjen e rezultatit operativ të vitit.

### 3.4 Të ardhura dhe shpenzime financiare

Të ardhurat financiare përfshijnë të ardhura interesi nga llogaritë bankare.Të ardhurat nga interesi njihen mbi bazën e të drejtave të konstatuara duke përdorur metodën e interesit efektiv.
Shpenzimet financiare përfshijnë shpenzime interesi mbi huamarrjet dhe fitim/humbjet nga kursi i këmbimit që lidhen me to.

### 3.5 Tatimi mbi fitimin

Tatim fitimi i vitit përbëhet nga tatimi aktual. Tatim fitimi njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve përveç rasteve kur lidhet me zëra që njihen direkt në kapital, rast në të cilin edhe tatimi njihet në kapital. Tatimi aktual është tatimi i pritur për t'u paguar mbi fitimin e tatueshem të vitit, duke aplikuar normat tatimore në fuqi në datën e bilancit, si dhe çfarëdolloj rregullimi kontabël të tatimit për t'u paguar në lidhje me vitet e mëparshme. Norma e tatimit mbi fitimin për vitin 2020 është 15% (2019: 15%).

### 3.6 Transaksionet me palët e lidhura

Palët e lidhura përcaktohen kur një palë kontrollohet nga pala tjetër, ose ka ndikim të rëndësishëm në vendimet e biznesit apo vendimet financiare të palës tjetër. Për qëllime të paraqitjes së pasqyrave financiare, drejtimi i shoqërisë dhe manaxhimi konsiderohen si palë të lidhura.

## 4 Mjete monetare

Mjetet monetare në arkë dhe bankë detajohen si më poshtë më 31 dhjetor 2020 dhe 31 dhjetor 2019:

| | 31 dhjetor 2020 | 31 dhjetor 2019 |
|---|---|---|
| Mjete monetare në bankë | 6,495,717 | 12,333,846 |
| Në lekë | 6,076,891 | 11,043,855 |
| Në monedhë të huaj | 418,826 | 1,289,991 |
| Mjete monetare në arkë | - | - |
| | **6,495,717** | **12,333,846** |

## 5 Llogari të arkëtueshme nga palët e lidhura

Të tjera llogari të arkëtueshme nga palët e lidhura më 31 dhjetor 2020 dhe 31 dhjetor 2019 paraqiten si më poshtë:

| | 31 dhjetor 2020 | 31 dhjetor 2019 |
|---|---|---|
| Të tjera Llogari të arkëtueshme nga palët e lidhura | 15,069,669 | 13,286,843 |
| | **15,069,669** | **13,286,843** |

## 6 Të tjera llogari të arkëtueshme

Llogaritë të tjera të arketueshme më 31 dhjetor 2020 dhe 31 dhjetor 2019 paraqiten si më poshtë:

| | 31 dhjetor 2020 | 31 dhjetor 2019 |
|---|---|---|
| TVSH për tu rimbursuar | 1,373,423 | 1,093,482 |
| Tatim Fitim i parapaguar | 240,180 | 200,876 |
| Tatime të tjerë | 37 | 37 |
| | **1,613,640** | **1,294,395** |

## 7 Shpenzime të shtyra

Parapagimet dhe shpenzimet e shtyra më 31 dhjetor 2020 dhe 31 dhjetor 2019 paraqiten si më poshtë:

| | 31 dhjetor 2020 | 31 dhjetor 2019 |
|---|---|---|
| Paradhënie për punonjësit | 553,752 | - |
| Parapagime të dhëna | 89,619 | - |
| | **643,371** | **-** |

## 8 Aktive afatgjata materiale

| | Mobilje dhe orendi | Kompjutera | Totali |
|---|---|---|---|
| ***Kosto*** | | | |
| Gjendja më 1 janar 2019 | 769,803 | 664,489 | 1,434,292 |
| Shtesa | 21,817 | - | 21,817 |
| Nxjerrje jashtë përdorimit | (12,983) | - | (12,983) |
| **Gjendja më 31 dhjetor 2019** | **778,637** | **664,489** | **1,443,126** |
| Shtesa | | 345,837 | 345,837 |
| Nxjerrje jashtë përdorimit | - | - | - |
| **Gjendja më 31 dhjetor 2020** | **778,637** | **1,010,326** | **1,788,963** |
| ***Amortizimi i akumuluar*** | | | |
| Gjendja më 1 janar 2019 | 629,096 | 532,067 | 1,161,163 |
| Amortizimi i vitit | 29,145 | 33,105 | 62,250 |
| Nxjerrje jashtë përdorimit | (11,502) | - | (11,502) |
| **Gjendja më 31 dhjetor 2019** | **646,739** | **565,172** | **1,211,911** |
| Amortizimi i vitit | 26,379 | 95,555 | 121,934 |
| Nxjerrje jashtë përdorimit | - | - | - |
| **Gjendja më 31 dhjetor 2020** | **673,118** | **660,727** | **1,333,845** |
| *Vlera neto kontabël* | | | |
| **Gjendja më 31 dhjetor 2019** | **131,898** | **99,317** | **231,215** |
| **Gjendja më 31 dhjetor 2020** | **105,519** | **349,599** | **455,118** |

## 9 Të tjera llogari të arkëtueshme afatgjata

Llogaritë e tjera të arkëtueshme afatgjata më 31 dhjetor 2020 dhe 31 dhjetor 2019 paraqiten si më poshtë:

| | 31 dhjetor 2020 | 31 dhjetor 2019 |
|---|---|---|
| Garanci per Qira | 235,348 | 235,348 |
| Depozite roaming (Vodafone) | 56,500 | 56,500 |
| | **291,848** | **291,848** |

## 10 Llogari të pagueshme tregtare

Llogaritë e pagueshme tregtare më 31 dhjetor 2020 dhe 31 dhjetor 2019 paraqiten si më poshtë:

| | 31 dhjetor 2020 | 31 dhjetor 2019 |
|---|---|---|
| Furnitorë | 91,494 | 728,754 |
| Fatura të pambërritura | 22,463 | - |
| | **113,957** | **728,754** |

## 11 Të pagueshme ndaj palëve të lidhura

Të pagueshmet ndaj palëve të lidhura më 31 dhjetor 2020 dhe 31 dhjetor 2019 paraqiten si më poshtë:

| | 31 dhjetor 2020 | 31 dhjetor 2019 |
|---|---|---|
| Të pagueshme ndaj palëve të lidhura | 7,646,660 | 9,657,333 |
| Fatura të pambërritura | 1,329,326 | - |
| | **8,975,986** | **9,657,333** |

## 12 Hua nga palët e lidhura

Huatë nga palët e lidhura më 31 dhjetor 2020 dhe 31 dhjetor 2019 paraqiten si më poshtë:

| | 31 dhjetor 2020 | 31 dhjetor 2019 |
|---|---|---|
| Alpiq AG | 12,370,000 | 12,177,000 |
| Alpiq Energy SE | - | 2,130,975 |
| | **12,370,000** | **14,307,975** |

## 13 Detyrime tatimore

Detyrimet tatimore për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020 dhe 31 dhjetor 2019 detajohen si më poshtë:

| | 31 dhjetor 2020 | 31 dhjetor 2019 |
|---|---|---|
| Tatim mbi të ardhurat Personale | 99,299 | 88,426 |
| Sigurime Shoqërore dhe Shëndetësore | 66,898 | 65,301 |
| Tatim në burim | 25,449 | 20,149 |
| | **191,646** | **173,876** |

## 14 Të tjera detyrime

Detyrimet e tjera paraqesin detyrimet ndaj punonjësve dhe detyrime të tjera më 31 dhjetor 2020 dhe 31 dhjetor 2019 si më poshtë:

| | 31 dhjetor 2020 | 31 dhjetor 2019 |
|---|---|---|
| Të tjerë debitorë dhe kreditorë | 384,000 | 644,785 |
| Paga të pagueshme | 373,699 | 338,100 |
| Dite pushimi te papaguara | 260,846 | - |
| | **1,018,545** | **982,885** |

## 15 Kapitali themeltar

Kapitali themeltar i Shoqërisë është në vlerë 17,625,000 lekë.

### Humbje e akumuluar

Humbja e akumuluar e Shoqërisë është (16,037,676) lekë.

### Fitimi i ushtrimit

Shuma prej 311,905 lekë përfaqeson fitimin për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2020

## 16 Të ardhurat

Shoqëria gjatë vitit 2020 dhe 2019 ka realizuar të ardhura si më poshtë:

| | Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020 | Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019 |
|---|---|---|
| Të ardhura nga shërbimet | 15,069,669 | 13,286,843 |
| | **15,069,669** | **13,286,843** |

## 17 Të ardhurat të tjera të shfrytëzimit

Të ardhurat e tjera të shfrytëzimit përfshijnë fitim/humbjet që vijnë nga ndryshimi i kursit të këmbimit nga aktiviteti tregtar dhe detajohen si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020 dhe 31 dhjetor 2019

| | Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020 | Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019 |
|---|---|---|
| Humbje nga këmbimet e llogarive tregtare | (1,083,932) | (412,146) |
| Fitim nga këmbmet e llogarive tregtare | 676,719 | 400,869 |
| | **(407,213)** | **(11,277)** |

| | 31 Dhjetor 2020 |
|---|---|
| **Rakordimi i të ardhurave me FDP-në** | |
| Qarkullim i tatueshëm | 19,462,527 |
| Zbriten Autofaturimet 2020 | (6,175,684) |
| Efekti I kursit te kembimit | 1,634,654 |
| Te ardhurat e parashikuara te faturuara ne 2021 | 15,069,669 |
| Te ardhura te 2019, faturuar ne 2020 | (13,286,843) |
| **Shuma e qarkullimit e korrektuar** | **16,704,323** |
| Sipas Kontabilitetit | 16,704,323 |
| **Diferenca** | - |

## 18 Të tjera shpenzime

Shpenzimet e tjera detajohen si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020 dhe 31 dhjetor 2019:

| | Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020 | Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019 |
|---|---|---|
| Shpenzime të tjera | 5,875,652 | 6,680,060 |
| Shpenzime qeraje | 1,267,512 | 1,256,275 |
| Shërbime nga të tretë | 763,595 | 767,349 |
| Shpenzime postare dhe telekomunikacioni | 293,284 | 243,563 |
| Komisione bankare | 92,253 | 84,050 |
| Taksa të ndryshme | 112,500 | 101,630 |
| Anëtarësime | 136,263 | 134,428 |
| Shpenzime reklamimi | - | 29,577 |
| Blerje Energji | 33,914 | 20,513 |
| Shpenzime Transporti | 82,680 | 60,500 |
| Vlera kontabël e aktiveve | - | 1,481 |
| Shpenzime ERE | 410,840 | 122,922 |
| Shpenzime kancelarie | 55,800 | - |
| Dite pushimi te pakryera | 260,846 | - |
| | **9,385,139** | **9,502,348** |

## 19 Shpenzime të personelit

Shpenzimet e personelit për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020 dhe 2019 janë si më poshtë:

Për 2020 shpenzimet e personelit deklaruar në Drejtorinë Tatimore janë 4,622,959 lekë. Mospërputhja me shumën 774,480 lekë e shpenzimit të pagës bruto të deklaruar në FDP vjen si rezultat i pagës së papaguar të administratorit e cila llogaritet vetëm për efekt sigurimesh dhe nuk paguhet.

| | Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020 | Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019 |
|---|---|---|
| Shpenzime për paga | 3,848,479 | 2,915,702 |
| Shpenzime për sigurime shoqërore e shëndetësore | 428,997 | 413,141 |
| | **4,277,476** | **3,328,843** |

## 20 Shpenzime amortizimi

Shpenzimet e amortizimit më 31 dhjetor 2020 dhe 31 dhjetor 2019 paraqiten si më poshtë:

| | Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020 | Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019 |
|---|---|---|
| Shpenzime amortizimi | 121,934 | 62,250 |
| | **121,934** | **62,250** |

## 21 Shpenzime financiare

Shpenzimet financiare përfshijnë shpenzimet e interesit dhe rezultatin nga kursi i këmbimit që lidhet me aktivitetin financiar të shoqërisë, si dhe të ardhurat nga penaliteti. Ky zë detajohet si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020 dhe 31 dhjetor 2019:

| | **Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020** | **Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019** |
|---|---|---|
| Shpenzime Interesi | (219,821) | (238,948) |
| Humbje nga këmbimet e llogarive tregtare | (1,193,420) | (491,711) |
| Fitim nga kembimet e llogarive tregtare | 957,935 | 696,121 |
| Fitime te tjera financiare | - | 20,210 |
| | **(455,306)** | **(14,328)** |

## 22 Shpenzimi i tatimit mbi fitimin

Shoqëria është subjekt i Tatimit mbi të ardhurat në Shqipëri, norma e të cilit është 15% (2019: 15%). Formularët e deklarimit të Tatimit mbi të ardhurat paraqiten çdo vit pranë autoriteteve tatimore, por të ardhurat dhe shpenzimet të deklaruara për qëllime të tatueshme konsiderohen vetë deklarime deri në momentin që janë vëzhguar dhe vlerësuar nga autoritetet tatimore.

Legjislacioni Tatimor dhe Ligjet Shqiptare janë subjekt interpretimi nga autoritetet tatimore.

| | **31 dhjetor 2020** | **31 dhjetor 2019** |
|---|---|---|
| ***Fitimi para tatimit*** | **422,601** | **367,797** |
| Total shpenzime të panjohura | 315,372 | 370,397 |
| ***Fitimi para tatimit (përfshirë shpenzimet e panjohura)*** | **737,973** | **738,194** |
| Tatim fitimi 15% | (110,696) | (110,729) |
| **Fitim/( Humbja) Neto** | **311,905** | **257,068** |

## 23 Transaksionet me palët e lidhura

Gjendjet dhe transaksionet me palët e lidhura për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020 dhe 31 dhjetor 2019 janë të detajuara si më poshtë:

| | 31 Dhjetor 20 | | 31 Dhjetor 19 | |
|---|---|---|---|---|
| | **Te arketueshme** | **Te pagueshme** | **Te arketueshme** | **Te pagueshme** |
| Alpiq Energy SE | 15,069,669 | 2,968,725 | 13,286,843 | 1,468,088 |
| Alpiq Services CZ s.r.o. | - | 5,967,508 | - | 8,123,851 |
| Alpiq AG | - | - | - | 46,039 |
| Alpiq Holding AG | - | 39,753 | - | 19,351 |
| | **15,069,669** | **8,975,986** | **13,286,843** | **9,657,333** |

| | 31 Dhjetor 20 | | 31 Dhjetor 19 | |
|---|---|---|---|---|
| | **Shitje** | **Blerje** | **Shitje** | **Blerje** |
| Alpiq Energy SE | 15,069,669 | 1,497,033 | 13,286,843 | 1,493,472 |
| Alpiq Services CZ s.r.o. | - | 4,481,614 | - | 4,347,561 |
| Alpiq AG | - | 187,035 | - | 183,950 |
| Alpiq Holding AG | - | 17,754 | - | 22,766 |
| | **15,069,669** | **6,183,436** | **13,286,843** | **6,047,749** |

| | 31 Dhjetor 20 | 31 Dhjetor 19 |
|---|---|---|
| | **Hua** | **Hua** |
| Alpiq AG | 12,370,000 | 12,177,000 |
| Alpiq EnergySE | - | 2,130,975 |
| | **12,370,000** | **14,307,975** |

## 24 Angazhime dhe pasiguri

*Çështje gjyqësore*

Gjatë aktivitetit të saj të zakonshëm, Shoqëria mund të përfshihet në pretendime apo veprime të ndryshme ligjore nga palë të treta. Bazuar në opinionin e drejtuesve të Shoqërisë, konkluzioni përfundimtar në lidhje me këto çështje nuk do të ketë efekte negative në pozicionin financiar të Shoqërisë ose ndryshime në aktivet neto të saj. Me 31 Dhjetor 2020 Shoqëria nuk ka asnjë Çështje gjyqësore të hapur kundrejt saj apo nga ajo, që mund të kërkojë rregullime të këtyre pasqyrave financiare.

*Detyrimet tatimore*

Librat e Shoqërisë nuk janë audituar nga organet tatimore për vitin e mbyllur me 31 Dhjetor 2020. Si rrjedhojë detyrimet tatimore nuk mund të konsiderohen përfundimtare. Detyrime të mundshme që mund të rezultojnë nga një auditim i organeve tatimore nuk mund të maten në mënyrë të besueshme.

Detyrime të ardhshme për qeranë operative

| | **Më 31 dhjetor 2020** | **Më 31 dhjetor 2019** |
|---|---|---|
| Brenda një viti | 1,261,740 | 1,242,054 |
| Më shumë se një vit, më pak se pesë vjet | - | - |
| **Totali** | **1,261,740** | **1,242,054** |

## 25 Ngjarje pas bilancit

Nuk ka asnjë ngjarje pas datës së bilancit e cila kërkon rregullime apo shpjegime në këto pasqyra financiare.